

Deklaratë për Shtyp


**ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË
TREMUIJORIN E PARË TË VITIT 2009**

— Qershor 2009

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2009 rezultoi me një pakësim mjetesh valutore prej 131 milionë euro. Tremujori i parë i vitit u mbyll me një deficit të llogarisë korente prej 334 milionë eurosh. Në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2008, deficitin korent regjistroi një rritje prej rreth 67 milionë eurosh, nga 267 milionë euro. Deficiti i tregtisë së mallrave u tkurr me 11 milionë euro gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 dhe u vlerësua në 516 milionë euro nga 527 milionë euro në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Flukset hyrëse të kapitalit regjistruan vlerën 247 milionë euro duke financuar rreth 74% të deficitit korent.


I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 regjistruan rreth 1,930 milionë euro, duke qenë 7% më të ulëta se një vit më parë. *Llogaria korente* regjistroi një deficit prej 334 milionë eurosh, krahasuar me 267 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Thellimi i deficitit pasqyron rënien e suficitit të *transfertave korente* (nga 243 milionë euro në 213 milionë euro), një ndryshim të kahut të bilancit në kategorinë të *ardhura* nga suficit (20 milionë euro) në deficit (4 milionë euro) dhe thellimin e deficitit në *shërbime* (nga 3 milionë euro në 27 milionë euro). Ndërkohë, deficitin në *mallra* u tkurr në 516 nga 527 milionë euro. Rreth 61% e shpenzimeve korente kanë shkuar për financimin e *importeve të mallrave*, ndërkohë që hyrjet valutore janë siguruar nga *eksportet e shërbimeve* dhe të *mallrave* (60%) dhe nga *transfertat korente* të njëanshme (32%).




II. TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 shënoi 869 milionë euro, me një rënie vjetore prej 8%. Shitblerja e mallrave përfaqësoi rreth 45% të veprimeve korente. *Eksportet* shënuan një rënie vjetore prej 15% dhe vlerësohen në 176 milionë euro, ndërkohë që për *importet* u paguan 692 milionë euro ose 6% më pak se një vit më parë. *Deficiti tregtar* u tkurr me rreth 11 milionë euro duke arritur në 516 milionë euro. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet ra në nivelin 25% nga 28% një vit më parë.



Pagesat për importet e mallrave ushqimore kanë rënë me 15% ndërsa ato për lëndë djegëse me 30%. Ndërkohë, janë rritur vlerat e importeve të *makinerive dhe pajisjeve* (4%) dhe të *produkteve kimike* (19%). Vlera e importeve të këtyre katër kategorive shënoi rreth 63% të vlerës së përgjithshme të importeve. Në krahun e eksporteve, eksportet nga industria e *tekstileve dhe e këpucëve* ranë me 8%. Eksportet e këtyre kategorive vazhdojnë të renditen të parat duke siguruar rreth 54% të të ardhurave të përgjithshme nga eksportet.



Gjatë tremujorit të parë të vitit është regjistruar rënie e ndjeshme në vlerën e eksporteve të metaleve (me 54%), gjë që ka bërë që eksporti i përgjithshëm nga prodhimi i brendshëm të bjerë me rreth 23%.


III. ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Llogaria e shërbimeve gjatë këtij tremujori ka regjistruar rënie si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Shkëmbimet tregtare në shërbime ishin rreth 633 milionë euro, me një rënie vjetore prej 10%. Ndaj tremujorit të parë të vitit 2008, të ardhurat ranë me 14% ndërsa shpenzimet me 7%. Rezultati neto i transaksioneve ishte thellimi i deficitit të shërbimeve, i cili arriti në 27 milionë euro nga 3 milionë euro një vit më parë.

Shërbimet e udhëtimit zënë peshën më të madhe në të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve, me përkatësisht 70% dhe 67%. Bilanci neto i shërbimeve të udhëtimit shënoi një deficit prej rreth 10 milionë eurosh. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 212 milionë euro ose 4% më pak se sa në vitin 2008. Rënia e të ardhurave gjatë këtij tremujori është kryesisht pasojë e rënies së lehtë të shpenzimeve mesatare ditore të jorezidentëve vizitorë. Ndërkohë, rezidentët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit rreth 220 milionë euro ose 4% më tepër se një vit më parë. Në këtë rritje ka ndikuar rritja e shpenzimeve mesatare ditore, dhe një rritje e lehtë në kohëzgjatjen e qëndrimit, edhe pse numri i udhëtarëve shqiptarë ka shënuar rënie ndaj tremujorit të parë të vitit të kaluar.

Llogaria e të ardhurave u mbyll me një bilanc negativ prej 4 milionë eurosh. Të hyrat në valutë të kësaj kategorie ranë rreth 15%, ndërkohë që, daljet u rritën me 25%. Dy burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë puna e punëtorëve sezonalë dhe kufitarë, dhe të ardhurat nga investimet. Shqipëria gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 ka paguar 7.2 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

Transfertat korente neto u vlerësuan në rreth 213 milionë euro, nga të cilat rreth 196 milionë euro kanë hyrë në formën e dërgesave të emigrantëve. Këto të fundit shënuan një rënie vjetore prej rreth 8% nga vlera prej 213 milionë eurosh e një viti më parë.




IV. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, rezultuan në një prurje neto prej rreth 247 milionë eurosh në llogarinë kapitale dhe financiare. Nga këto, rreth 20 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e granteve për investime kapitale, ndërsa 227 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Flukset hyrëse të kapitalit kanë financuar në masën 73% deficitin korent prej 337 milionë eurosh. Llogaria financiare regjistroi një rritje prej rreth 150 milionë eurosh në detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj botës dhe rënie me rreth 70 milionë euro të mjeteve të rezidentëve jashtë. Në rritjen e detyrimeve ndaj jorezidentëve, rol kryesor ka luajtur rritja e investimeve të huaja direkte me 124 milionë euro. Rënia e mjeteve financiare është shkaktuar kryesisht nga rënia e mjeteve në formën e depozitave të sistemit bankar me institucionet financiare jorezidente me rreth 60 milionë euro.

Lëvizimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë gjatë tremujorit të parë të këtij viti vlerësohen në 33 milionë euro nga 23 milionë euro në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Rreth 75% e huasë është përdorur për investime të sektorit publik. Ndërkohë, huamarrja private ka qenë rreth 9 milionë euro duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e detyrimeve për pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm. Shërbimi i borxhit të jashtëm për tremujorin e parë të vitit 2009 ka ulur detyrimet e rezidentëve me rreth 7.3 milionë euro.

Mjetet e rezervës kanë rënë me 131 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të tremujorit të parë të vitit 2009 shënoi nivelin 1,595 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 4.7 muajve importesh të mallrave dhe të shërbimeve.



Bilanci i pagesave (në milionë euro).

	T1'08	T2'08	T3'08	T4'08	T1'09
Llogaria korente	(267.3)	(363.5)	(230.7)	(457.4)	(334.2)
Eksporti i mallrave	206.5	260.4	242.0	208.6	176.1
Importi i mallrave	(733.9)	(821.6)	(844.0)	(949.5)	(692.5)
Bilanci tregtar	(527.3)	(561.3)	(602.0)	(740.9)	(516.4)
Shërbimet: Kredi	351.9	397.9	517.7	420.2	303.2
Shërbimet: Debi	(355.2)	(415.8)	(430.5)	(416.8)	(330.0)
Të Ardhurat: Kredi	75.0	66.7	97.2	77.8	63.5
Të Ardhurat: Debi	(54.5)	(84.1)	(42.3)	(29.3)	(67.9)
Transferta private pa shpërblim	236.9	226.8	217.9	223.7	211.2
Transferta shtetërore pa shpërblim	6.0	6.3	11.3	7.9	2.2
Llogaria kapitale	12.9	17.7	27.2	20.3	19.6
Llogaria financiare	154.2	354.7	180.8	764.8	226.9
Investime direkte	81.4	112.0	157.3	239.8	122.3
Investime portofoli	1.0	0.6	(11.7)	(59.1)	3.0
Kapitale të tjera*	74.7	241.8	36.0	586.0	103.0
Gabime dhe harresa neto	73.2	0.9	141.1	(237.2)	(43.3)
Bilanci i përgjithshëm	(27.0)	9.9	118.5	90.5	(130.9)
Mjetet e rezervës	27.0	(9.9)	(118.5)	(90.5)	130.9
Përdorim huash e kredish nga FMN	(2.9)	0.3	(0.7)	(1.8)	(1.3)
Ndryshimi total në rezerva	(66.2)	6.8	180.8	97.1	(101.0)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(39.3)	(3.0)	62.3	6.6	29.8

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënime:

Rishikimi i të dhënave

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në përputhje me politikat e rishikimit të informacionit statistikor të Bankës së Shqipërisë, statistikave të bilancit të pagesave i janë nënshtruar rishikimit për periudhën janar-dhjetor të vitit 2008.

Informacion ndihmës për statistikave të bilancit të pagesave

Të dhëna të plota dhe të përditësuara të bilancit të pagesave publikohen çdo tremujor në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, në drejtorinë "Statistika"/Seri Kohore/Statistika të Sektorit të Jashtëm /Bilanci i Pagesave.

Një material i detajuar mbi metodologjinë e përdorur për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave gjendet në drejtorinë "Statistika", seksioni "Publikime për Statistikat", nën titullin *Metodika e Bilancit të Pagesave*.